

# "Pleqëri me Dinjitet"

## PERSHKRIMI I PROJEKTIT

<b>Emri i Projektit</b>	"Pleqëri me dinjitet"	<b>Vendi i realizimit</b> <b>Regjioni i Prizrenit</b>
<b>Implementuar nga:</b>	SHHBK Nena Tereze	Periudha implementuese 01/05/2023 - 28/02/2024
<b>Mbeshtetur nga:</b>	Ministria e Drejtësisë, Republika e Kosovës	

## Qëllimi dhe objektivat

- Qëllimi i këtij projekti është që të mbështeten 30 personat e moshuar ,të vetmuar dhe pa përkujdesje të mjaftueshme,duke e ngritur nivelin perkujdesjes shëndetsore,ushqyeshmërisë, dhe sociale në pergjithësi në Rajonin e Prizrenit

### ***Ndersa objektivat e projektit Jane:***

- Shërbime cilësore ditore për personat e moshuar dhe të vetmuar pa përkujdesje familjare
- Ngritja e nivelit të social për një jetë më të dinjitetshme të këtij grupi personash
- Sigurimi i mbështetjes shëndetsore duke siguruar mbeshtetje shëndetshme,referime ,keshillime
- Rritja e nivelit të ushqyeshmërisë së këtyre personave

## Pershkrim i projektit

Në Kosovë, evidencat që tregojnë gjëndjen socio ekonomike dhe kualitetin i jetës të moshuarve është e mangët, gjëndjen e veshtireson edhe me shumë inflacioni i cili perfshiu tere boten, perفشire ketu edhe Kosoven me 11.2% inflacion ne shkalle te vendit.. Mosha e trete është kategori qe kerkon vemendje te vecant, e para per shkak te mundesive te kufizuara

jetesore si rrjedhojë e moshës dhe degradimit shëndetsorë pafuqishëm të jënës të pavarur. Me moshë rrethanas ndryshojnë, për tu kujdesur për veten behet sa e me e veshtirë andaj projektet që ofrojnë shërbime dhe kujdes shtëpiake janë të domosdoshëm. Projekti synon të ngris nivelin e **ushqyeshmerisë**, **shëndetsor** dhe atij *psiko-social* gjatë realizimit të projektit si perkrahje ndaj pasojave afatgjatë të shkaktuara nga COVID 19, inflacionit si dhe tendencave demografike të levizjeve dhe emigracionit.

## Aktivitetet e projektit

- Vizitat nga ana e ekipit shëndetsorë (mjeku dhe motra) tek perfituesit në vazhdimësi.
- Shpërndarja e gjerave ushqimore, joushqimore dhe higjienike për të gjithë perfituesit.
- Furnizimi me medikamente të nevojshme për perfitues.
- Aktivitete psikosociale për perfituesit e projektit.
- Sigurim i transportit për perfituesit me levizshmeri të kufizuar
- Monitorimi I projektit në vazhdimësi nga ana e menagjmentit dhe pergjegjesve të tjere



- **Ngritja e nivelit të social për një jetë më të dinjitetshme të këtij grupi personash**
- **Sigurimi I mbështetjes shëndetësore duke siguruar jetë të shëndetëshme**
- **Rritja e nivelit të ushqyeshmërisë së ketyre personave janë tre shtylla të projektit**

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), mjediset fizike dhe shoqërore janë përcaktuesit kryesorë të faktit nëse njerëzit mund të qëndrojnë të shëndetshëm, të pavarur dhe autonomë në moshën e tyre të vjetër. Si dhe të fuqizojë të moshuarit në moshë, në shëndet më të mirë fizik dhe mendor, Këto mjedise promovojnë përfshirjen e tyre sociale dhe pjesëmarrjen aktive dhe t'i ndihmojnë ata të ruajnë autonominë e tyre dhe një cilësi të mirë të jetës në moshën e tyre të shtyer

*Dashuria fillon duke u kujdesur për më të varferit”- Nëna Terezë*



**Rreth organizates SHHBK Nena Tereze :** E themeluar në vitin 1990, Organizata Nënë Tereza (NT) është organizata e parë joqeveritare e Kosovës. Që nga themelimi i saj, NT ka mbetur i përkushtuar ndaj një misioni të vetëm dhe të gjithanshëm: të ndihmojë popullsitë më të cenueshme të Kosovës, pa marrë parasysh kombësinë, racën, fenë, përkatësinë gjinore ose përkatësinë politike dhe t'u japë atyre mjetet për të mbështetur veten. Ajo ka (5) pesë zyra rajonale, 200 vullnetarë dhe 12 punonjës me orar të plotë. Organizata Nënë Tereza angazhohet për drejtësi sociale dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ne promovojmë të drejtën për një jetë dinjitoze. Kjo do të thotë një jetë e lirë nga varfëria, dhuna, diskriminimi ose shkeljet e të drejtave të njeriut.

**Adresa:** SHHBK Nena Tereze Muje Krasniqi nn Ulpiana U1/1 **Kontakti:** +383 38 542 864/5 **email:** ntereze@yahoo.com,.